



REPUBLIC OF KOSOVO REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERV. OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar Prenjese / Prodato Received / Delivered	23.04.2021	1	viti god year
Organ / Agjencia Org / Jedinica Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHOCK	1990/2021		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.187/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2369/2019 të datës 23.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.152/2019 të datës 01.03.2019 e parashtruar nga ankuesi me adresë Rr. "Bill Clinton" Nr.25, Prishtinë, kundër Vendimit me numër protokolli 008/1/19 të datës 05.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 23.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.152/2019 e datës 01.03.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 008/1/19 i datës 05.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 09.03.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1072/2021 të regjistruar me numër A.nr.152/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës Për Shërbimin Civilë, kundër Vendimit me numër protokolli 008/1/19 i datës 05.02.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional për shkak të mos emërimit të anëtarëve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me ç'rast Këshilli me shkresën me numër protokolli 4196/2019 të datës 06.09.2019, ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës së tij me numër A.nr.

152/2019 të datës 01.03.2019, duke udhëzuar palën ankuese mbi të drejtën e ndjekjes së procedurës gjyqësore në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Pas këtij njoftimi të Këshillit, ankuesi ka hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, e cila me Aktgjykimin A.nr.2369/2019 të datës 23.03.2021 i pranuar në Këshill me datë 25.03.2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar Njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 04.09.2019 dhe ka detyruar Këshillin që të vendos lidhur me ankesën e ankuesit të datës 01.03.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër Ankesën me numër A.nr.819/2018, të datës 11.12.2018 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; ankesës A. Nr.187/2021, të datës 25.03.2021, sipas Aktgjykimit A. Nr. 2369/2019, të datës 12.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë / Departamenti për Çështje Administrative. Ankesën Nr.661/2/18 të datës 17.10.2018 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin Nr.152/1/18 të datës 19.11.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesa për përgjigje e datës 12.12.2018; Përgjigja në kërkesë e datës 18.12.2018; Konkurs Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit i datës 23.03.2004 Vendimi i datës 22.04.2004; Kontrata e punës e datës 03.05.2004; Rendi i ditës i datës 21.04.2006; Kontratë e datës 01.06.2006; Kontrata e datës 02.07.2007; Kontrata e datës 20.02.2008; Kontrata e datës 25.01.2010; Kontrata e datës 30.11.2010; Akt emërim i datës 01.01.2012; përskrimi i vendit të punës; Konkursi i datës 06.06.2014; Vendimi i datës 02.11.2018; E-mail zyrtar i datës 19.11.2018; E-mail zyrtar i datës 16.11.2018; E-mail zyrtar i datës 13.11.2018; Vendimi i datës 10.07.2015; Deklarata e datës 10.07.2015; Vërtetim i datës 06.02.2014, Vërtetim i datës 11.06.2015; Vërtetim i datës 16.03.2015 dhe vendimi i datës 04.07.2018; Ankesë me numër protokolli 1072/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e datës 01.03.2019; E-mail nga K.G. për I.A. i datës 30.03.2017; Vendim me numër protokolli 327/2019 i datës 21.01.2019; Vendim me numër 008/1/19 i datës 05.02.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare; Njoftim i datës 04.09.2019; E-mail nga D.J. për H.M. i datës 30.05.2019; E-mail nga R.J. për H.M. i datës 30.05.2019; Njoftim i datës 02.08.2018; Formulari i të dhënave për listën e pagave i datës 01.08.2018; Vendim i datës 04.07.2018; Kërkesë për pagesë retroaktive; Lista e pagave për muajin Korrik; Lista përfundimtare e punëtorëve të cilët i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjese të të hyrave, sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIKUT 2003/13 NSH KB "Likovci" (MIT006) Fi 1590/90 në Skenderaj, KK Skënderaj; Lista e pagave për muajin Mars 2015; Lista e pagave për muajin Dhjetor 2015; Lista e pagave për muajin Qershor 2018;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pasi ka analizuar provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi ka qenë i punësuar në Autoritetin Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (me tej ARKEP) nga viti 2004 deri në pensionimin e tij në korrik të vitit 2018.

Sipas vendimit të datës 22.04.2004 të Komisionit Përzgjedhës për Konkursin me numër reference ART10/103/04 të datës 23.03.2004, ankuesi është caktuar në pozitën "Zyrtar i Prokurimit", ndërsa sipas shkresave të lëndës të ofruara nga organi i punësimit, Kolegji gjen se ankuesi posedon Kontratë të Punës të datës 03.05.2004, me titull të pozitës Menaxher i Prokurimit" me kohëzgjatje

nga data 03.05.2004 deri 03.05.2006, Kontratë të Punës Nr.13/06 të datës 01.07.2006 në pozitën Menaxher i Prokurimit, në kohëzgjatje nga data 03.06.2006 deri 01.07.2007, Kontratë të Punës të datës 02.07.2007 në pozitën Menaxher i Prokurimit në kohëzgjatje nga data 02.07.2007 deri 31.12.2007, Kontratë të Punës me numër protokolli nr.022/08 të datës 20.02.2008 në pozitën e Zyrtarit të Prokurimit me kohëzgjatje nga data 20.02.2008 deri 31.12.2009, Kontratë të Punës me numër protokolli 001/10 të datës 25.01.2010 në pozitën e Zyrtarit të Prokurimit/Furnizues me kohëzgjatje nga 01.01.2010 deri 31.12.2011, Kontratë të Punës me numër protokolli 489/2/10 të datës 30.11.2010 në pozitën Furnizues/Zyrtar i Prokurimit me kohëzgjatje nga 01.01.2010 deri 31.12.2011, si dhe Akt Emërimin e datës 07.03.2012 në pozitën e Zyrtarit Administrativ/Pranimin e Mallit të cilën ankuesi nuk e ka nënshkruar.

Me arritjen e moshës së pensionimit, Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare ka nxjerrë Vendim me numër protokolli 118/1/18 të datës 04.07.2018 për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankuesit nga data 16.07.2018, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, duke i njohur të drejtën e realizimit të një pagë në vlerën e pagës së fundit.

Ankuesi kundër Vendimit me numër protokolli 118/1/18 të datës 04.07.2018, ka parashtruar ankesë me datë 17.10.2018 më me numër protokolli 661/2/18 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (me tej KZA) në Autoritetin Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, duke kundërshtuar edhe disa veprime tjera të organit të punësimit me pretendimin se i janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e tij punës.

KZKA me datë 19.11.2018 nxjerrë Vendim me numër protokolli 152/1/18 me të cilin e refuzon si të pa afatshme ankesën e datës 17.10.2018 të parashtruar nga ankuesi Ibrahim Ahmeti. Në afat ligjor ankuesi parashtron ankesë kundër Vendimit të KZKA me numër protokolli 152/2018 të datës 19.11.2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli me Vendimin A.nr.819/2018 të datës më datë 21.01.2019 ka shfuqizuar Vendimin me numër protokolli 152/2018 të datës 19.11.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, duke obliguar të njëjtin që të bëjë rishqyrtimin e ankesës së ankuesit me numër 661/2/18 të datës 17.10.2018.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit A.nr.819/2018 të datës 21.01.2019, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, ka rishqyrtuar ankesën e ankuesit me numër protokolli 661/2/18 të datës 17.10.2018 dhe me Vendimin numër protokolli 0081/1/19 të datës 05.02.2019, ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit si të jashtë afatshme.

I pa kënaqur me Vendimin numër protokolli 0081/1/19 të datës 05.02.2019 ankuesi brenda afatit ligjor, serish parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se Bordi i ARKEP në vitin 2006 pa asnjë arsytim ka larguar ankuesin nga pozita e Menaxherit të Prokurimit duke e dëmtuar të njëjtin financiarisht. Me tej thekson së organi i punësimit në kundërshtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civilë ka lëshuar Akt Emërim të datës 07.03.2012 për pozitën e Zyrtarit Administrativ-Pranimin i Mallit, në vend që të shndërroj Kontratën e Punës për pozitën e Zyrtarit të Prokurimit në Akt Emërim, dhe se ky vendim i kundërligjshëm ka ndikuar në dëmtimin moral, intelektual dhe financiar të ankuesit.

Me tutje mbështetur në Ligjin për Shërbimin Civilë kërkon që:

1. Të bëhet ndryshimi i Vendimit datës 04.07.2018 dhe të shkruhet titulli "Menaxher i Prokurimit" sipas marrëdhënies së punës në vitin 2004.

2. Të behët pagesa 50% për pozitën e dytë sekondare në mënyrë retroaktive sipas kontratës së datës 01.10.2010,-zyrtar furnizues për 96 muaj.
3. Për pozitën "Menaxher i Prokurimit" ti behët kompensimi material i ndryshimit të pagës me ndryshimin e vendit të tij të punës, për 96 muaj.
4. Ti kompensohet përvoja e punës për 96 muaj (0.5%) të paraparë me ligj.
5. Dokumentimi i përvojës në dokumentacionin përkatës
6. Kontributet e paguar në emër të të ardhurave personale të vërtetohen përmes një kontabilsliti dhe atë për periudhën nga 01.06.2001 deri me 16.07.2018.
7. Dhe se ankuesi nuk është informuar gjashtë muaj para pensionimit.

Nga vlerësimi i provave të lëndës me asnjë shkresë nuk vërtetohet se ankuesi ka kundërshtuar me mjete juridike (ankesë) largimin e tij nga pozita e Menaxherit të Prokurimit dhe nënshkrimi i Kontratës së Punës Nr.prot:022/08 të datës 20.02.2008 nënkupton pajtimin në heshtje të ankuesit me ndryshimin e pozitës së punës nga Menaxher i Prokurimit në pozitën e Zyrtarit të Prokurimit. Po ashtu përveç faktit të refuzimit të nënshkrimit, Kolegji nuk ka gjetur prova se ankuesi ka kundërshtuar Akt Emërimit të datës 07.03.2012 për pozitën e Zyrtarit Administrativ/Pranimi i Mallit, e që sipas ankuesit në mënyrë të kundërligjshme i është ndryshuar vendi i punës nga Zyrtar i Prokurimit në Zyrtar Administrativ-Pranimi Malli.

Duke u bazuar në nenin 50 paragrafi 1 dhe nenin 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave konstaton se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.* Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji pas shtjellimit të të gjitha provave të lëndës konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, me Vendimin numër 0081/1/19 të datës 05.02.2019 ka vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil dhe Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike lidhur me çështjen kontestuese, respektivisht pretendimet ankimore të ankuesit i referohen periudhës së emërimit të ankuesit në pozitën e Menaxherit të Prokurimit që sipas shkresave të lëndës ka të bëjë me periudhën kohore nga data 03.05.2004 deri 31.12.2007, Kontratës së Punës së datës 01.01.2010 dhe Akt Emërimit të datës 07.03.2012, e mbi këto fakte rrjedhe se ankesa e parashtruar në KZKA me datë 17.10.2018 lidhur me pretendimet ankimore të renditura nga 1 deri në 6 referuar kësaj ankese, është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor se ankuesi nuk është njoftuar 6 muaj para datës së pensionimit, bazuar në nenin 90 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil ku është përcaktuar se: *Mosha e pensionimit e nëpunësve civilë, si të gjinisë mashkullore ashtu edhe të asaj femërore, është gjashtëdhjetepesë (65) vjeç. 27 2. Nëpunësi civil informohet për përfundimin e punësimit, gjashtë (6) muaj para datës së pensionimit, nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës,* Kolegji vlerëson se mos njoftimi i ankueses në afat prej 6 muajsh para datës së pensionimit, nuk ka cenuar ndonjë të drejtë apo interes juridik të ankuesit lidhur me pensionimin, ngase bazuar në

shkresat e lëndës organi i punësimit në pajtim me nenin 19 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, ankuesit i ka realizuar pagesën në shumën prej një (1) page mujore të në vlerën e pagës së fundit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.187/2021

Clirim ZEKA

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare;
- Udhëheqësit të Personelit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare;
- Arkivit të KPMSHCK-së.